Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-62
Datë: 08.02.2018

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 22.01.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për ri akreditimin e Kolegjit UBT në Prishtinë, për periudhën tri vjeçare, prej 22. 01. 2018 deri 22. 01. 2021 për kurse për:

   1.1. Gjuhë Angleze.

   Akreditimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:
   Kushtet:

   - Të sigurojë dëshmi të politikës mbi zhvillimin profesional të shkathtësive të mësimdhënies i cili mbështetet në udhërrëfyesin e AKK-së si dhe të sistemeve efektive për implementimin e kësaj politike.
   - Të praktikojë vlerësimin përfundimtar me gojë për të gjithë kandidatët që ndjekin kurse ashtu që vlerësimi të jetë objektiv dhe i mbështetur në përshkrimet e KPERGJ-së.
   - Të përpilojë formularin për vlerësim të mësimdhënësve në gjuhën shqipe.
   - Formularët për vëzhgim që përdoren nga koordinatori i cilësisë dhe nga kolegët duhet të ketë pjesën ku nënshkruhen Koordinatori i cilësisë, respektivisht kolegu dhe mësimdhënësi.
   - Stafi mësimdhënës duhet të plotësojë standardet sa i përket nivelit të kualifikimit.

     (Afati kohor: 30. 06. 2016).

2. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit me datë: 31.10.2016, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1. Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

3. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

4. Vendimi i dërgohet:

- Kolegji UBT në Prishtinë; dhe
- AKK.

Kryetari i KD së AKK
Bedri Xhafa